



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 102/13
Prishtinë, më 29.04.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ymer Havolli, Adrian Zalli dhe Vërshim Hatipi nga FKPK, Shefki Ukaj, Arben Bilalli dhe Ganimet Nuiqi nga KPM, Lavdim Krasniqi dhe Suzana Pllana nga IGJK, Alban Sutaj, Drita Rexhepi dhe Daut Morina nga ANJF, Alexander Beetz, Lukas Fischer, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi nga GIZ, monitorues nga KDI/TIK, UNDP, Kosova Sot.

Mbledhjen e filloi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit, ndërsa e vazhdoi Naser Osmani, Zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013;**
3. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012;**
4. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2012;**
6. **Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes për kthimin e Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja theksoj se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

Kryetarja: Të nderuar anëtar të komisionit besoj që rendin e ditës e keni marr me kohë. Miratohet rendi i ditës

2. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e tarifave vjetore për vitin 2013

Kryetarja rikujtoi se për shkak të problemeve që janë hasur në ligjin për fondet pensionale, është vonuar kërkesa për miratimin e tarifave vjetore të Fondit nga ana Kuvendit, dhe derisa është miratuar plotësim ndryshimi i ligjit është shtyer edhe miratimi i taksës operationale dhe investive te fondit. Fondi ka propozuar për miratim taksën operationale prej 0.15 % dhe taksës investive 0.42% të mjeteve në menagjim. Nëse analizojmë krahasueshmërin me vitin e kaluar shohim që kërkesa e fondit pensional është më e madhe. Për shpenzimet investive është një kërkesë prej 3 milion e 500 mijë euro, që është rreth 900.000 euro më e lartë krahasuar me vitin e kaluar. Kemi po ashtu kërkesën për shpenzime operationale prej 1 milion e 48 mijë euro, që është 250 000 euro më e lart se vitin e kaluar. Shohim se ka lëvizje të pozicioneve edhe tek investimet ka shtim të mjeteve.

Ymer Havolli theksoi se ne kemi vepruar si institucion në bazë të kërkesave të ligjit dhe ju kemi drejtuar Kuvendit me kërkesë për miratim të kësaj tarife. Ne si bord i kemi propozuar Kuvendit miratimin e takses operationale prej 0.15% dhe të asaj investive 0.42% të mjeteve për vitin 2013. Nëse e marrim parasysh në mënyrë të vazhdueshme është duke u rritur masa e kontribuesve, dhe kjo masë pritet që deri në fund të vitit të jetë mbi 800 milion atëher edhe masa e servisimit ose mjetet investive për servisimin e këtyre mjeteve kërkojnë mjete më shumë.

Vërshim Hatipi theksoi se me rritjen e mjeteve në menagjim rriten edhe shpenzimet që lidhen me to. Për dallim të shpenzimeve të investimit, shpenzimet operationale qëndrojnë kryesisht të njëjta me përjashtim të një ngritje të një pozicioni, kjo për shkak të vendimit të bordit drejtues që ne të implementojmë një plan të rimëkëmbjes nga fatkeqësit dhe një plan gjithëpërfshirës i cili do të sigurojë ofrimin e shërbimeve të plota të fondit të kursimeve pensionale brenda 24 orëve, këtu përfshihen fatkeqësi të tilla si tërmetet.

Tek pjesa që flet për shpenzimet për investime këtu shohim plasimet e pritshme të mjeteve të kontribuesve, 9% të mjeteve mesatarisht gjatë vitit të jenë të alokuara në nëpër fletobligacionet e qeverisë së Kosovës të cilat nuk bartin taksa menagjuese nga qeveria e Kosovës. Më pas foli për investimin e mjeteve sipas asetmengjareve dhe koston për investimin e tyre e shprehur në përqindje, siq ishte paraqitur edhe në tabelën 1 të kërkesës. Këto quhen menagjim aktiv i mjeteve, për shkak se mjetet priten të jenë rreth 819 milion euro gjatë vitit 2013 duke i pasur parasysh këto alokime pra 9% fletobligacione të Kosovës, 36% Vanguard pritet që tarifat të arrijnë në 320.000 euro. Bordi ka parapar në tolerancë prej 10 % në mënyrë që të kemi hapësirë për manovrim për plasmane tjera të cilat nuk do të jenë pikërisht me këto % e parapara po ashtu të mos vijmë në Kuvend për së dyti herë nga fundi vitit në rast se kemi mungesë të fondeve për ti mbuluar shpenzimet e investimeve.

Ardian Zalli theksoi se nëse krahasojmë taksën menaxhuese të vitit 2012 të aprovuar nga Kuvendi gjatë vitit 2011 që ishte 0.60% dhe kërkesën për vitin 2013 që është 0.57% pra më e vogël, për shkak se janë rritur astet për kontribuesit. Ne kemi rreth 400.000 kontribues dhe kemi të dhëna për secilin prej tyre në baza mujore. Nëse e marrim mesataren janë diku rreth 4 deri 5 milion transaksione në baza vjetore. Do të thotë që kemi një databazë me informata shumë të mëdha për shumë kontribues të Kosovës dhe kemi planifikuar të sofistikuar për ruajtjen e tyre, në rast të ndonjë fatkeqësie.

Naser Osmani kemi nevojë për më shumë sqarime për arsye se kemi zbritje në %, po nuk kemi zbritje në shumat absolute do të thotë që kemi një rritje e konsiderueshme në krahasim me vitin e kaluar si shumë e parasë dhe kjo % nuk tregon shumë për arsye se ka rritje të fondit. Mua më intereson ky 10% i tolerancës, investimi që ju e keni menduar. A hyn kjo në këtë 0.42% ?

Ardian Zalli ne e kemi menduar që një tolerancë prej 10 % nëse aprovohet në mënyrë aktive prej Parlamentit do të ishte më mirë se sa do të kalohej psh qdo 3 ose 4 muaj te vijmë këtu.

Ymer Havolli sqaroi se një tolerancë e cila është lënë në mënyrë të qëllimshme nga bordi, në rast se nuk ka mjete të aprovuara në buxhet për operacione që në të shumtën e rasteve janë ditore dhe javore, për shkaqe të investimeve që duhet të servisohen për aset menagjer atëher e kemi lënë një tolerancë 10% si pjesë e cila do të mbetet.

Naser Osmani ne më ligj e kemi të rregulluar atë qështje në mungesë të mjeteve ju me një vendim i drejtoheni Kuvendit dhe Kuvendi ua lejonjë mjetet. Kështu që kjo nuk mund të mbetet si pjesë e tarifës dhe mendoj që pjesë prej 0.42% duhet zbritur kjo shumë prej 0,10%. Çka nënkupton për ju fatkeqësi, se këtu i keni futur mjetet për hardver edhe softver, pse gjithë ato mjete për hardver?

Ardian Zalli ne e kemi bërë një studim sa i përket se qfarë fatkeqësie mund të godasin institucionin që ne e udhëheqim. Rreziku më i madh për ne është zjarri. Nëse diqka ndodh dhe ndërtesa digjet, nuk digjen vetëm kompjuterët por edhe të dhënat edhe serverët që i kemi, dmth shpenzimet më të mëdha nuk janë për kompjuter por për server sepse serverët që ne i kemi dhe duhet mirëmbajtur të gjitha këto informatat që i thash më herët kushton relativisht shumë. Hardverin duhet ta kopjojmë po të njëjtin që e kemi dhe ta dërgojmë në një vend tjetër që në rast se kjo ndodh atëher i kemi informatat e njëjta në një vend tjetër. Janë edhe licensat softverike që kushtojnë shumë.

Naser Osmani ju nuk i keni të kopjuara të dhënat në një vend tjetër?

Ardian Zalli i kemi por në një form shumë primitive dhe te vjetër.

Naser Osmani cili është qëllimi, ju doni të bëni bunker si thesari?

Ardian Zalli do të jetë një sistem bashkëkohor që do të ketë serverin, static room, klimën, rojën të gjitha kushtet e nevojshme që në rast të fatkeqësive të ruhen të dhënat sepse duhet siguri e lartë për arsye se janë të dhëna shumë sensitiv.

Naser Osmani a ka mundësi të na sqaroni edhe njëher sigurimi fiduciar për anëtar e bordit. Është bërë edhe më parë?

Ymer Havolli sigurimi fidenciar parashihet ne ligj dhe qëllimi është për sigurim kundër akuzave, paraqitjeve në gjyq të anëtarëve të bordit, i cili i mbron ata nëse ata kanë vepruar në mënyrë të drejtë. Nuk i mbron ata nëse qëllimisht kanë bërë diqka në dëm të kontribuesve.

Sali Asllanaj mendoj që justifikimet që u dhanë ishin shumë bindëse dhe objektivist po shoh disa rritje të shpenzimeve operionale që i përmendët edhe ju. Konsideroj që taksën e përcaktojnë kompanit të cilat i menagjojnë aset-menagjerët dhe i caktojnë këto taksa që na i sjellin edhe neve. Unë mendoj që është një zbritje permanente e taksës mengjuese që e ka propozuar bordi dhe përkrahi këtë dhe ju dëshiroj sukses sa më të madh sepse kjo do të reflektoj tek ata kontribudhënës të pensioneve.

Latif Gashi do të doja disa sqarime tjera, si përveç rritjeve për shpenzime kapitale, keni planifikuar rritje për operacione, si për zyre ku është rreth 8% më shumë, qfarë keni dashur të thoni më këtë? Pastaj marrëdhënie me publikun janë planifikuar rreth 20.000 euro më shumë se vitin e kaluar? Po ashtu po e shoh se ka rritje për bordin udhëheqës ndërsa ka një planifikim, një ulje për punonjës dhe shërbyes profesional. Si e arsyetoni këtë?

Ardian Zalli për qështjen e operacioneve që ka pasur një rritje prej 8.2%, nëse e shikoni në operacione linja e dytë buxhetore është BQK tarifa e mbikqyrjes. Për shkak se neve na mbikqyrë BQK në baza vjetore prej vitit 2012 na ka dërgu një letër ku thuhet se për shkak se ne ju mbikqyrim ju ne do të bëjmë një evaluim të herë pas herëshëm kërkojmë prej jush që të na paguani një shumë që sillet rreth tarifës 0.6 % e tarifës menagjuese që sillet rreth 20.000 euro. Kjo nuk ka qenë e paraparë më herët. Sa i përket marrëdhënieve me publikun arsyeja është sepse numri i kontribuesve po rritet çdo vit. Për bordin udhëheqës e vetmja rritje është sigurimi fiduciar, kurse për punonjësit nëse e shikoni secili zë buxhetor ose ka mbetet njëjt ose është zvogëluar.

Sali Asllanaj ka qenë problemi i 15 milion eurove të cilat i kanë ardhur trustit pensional pa adresë, pa e ditur nga kush kanë ardhur. Keni pasur obligim me dit se nga kush dhe kujt i adresohen ato mjete. A keni bërë diçka dhe ku keni arritur?

Ardian Zalli ne gjatë muajit të ardhshëm do ta sjellim raportin vjetor tek ju në të cilin ju do të i shihni arritjet tona sa i përket qështjes në fjalë.

Naser Osmani: Si janë shpenzuar mjetet për këto 3 muaj kur ju nuk keni pasur një tarif të përcaktuar nga Kuvendi, a hyn këto shpenzimet e deritashme në këtë koeficient apo janë jashtë koeficientit?

Vërshim Hatipi nëse i shohim këta 3 muajt e parë nëse vazhdon kështu sepse ka pas performanc jashtëzakonisht të mirë të tregjeve financiare, sa më e mirë të jetë performanca aq më shumë rriten shpenzimet për investime.

Ymer Havolli ajo është tarifa e vitit 2012 dhe komisioni parlamentar e ka aprovuar ashtu që deri sa të bëhet amandamentimi i ligjit ne duhet të operojmë, ne kemi kërkuar që kjo të legalizohet derisa të vihet ligji dhe të amandamentohet ligji.

Naser Osmani unë propozoj që sot të aprovoj shpenzimet operacionale prej 0.15% dhe shpenzimet investive të zbriten 0.4% dhe të aprovohet me 0.38 %.

Pas diskutimeve, Komisioni me Nëntë Vota Për (Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj), asnjë Kundër dhe një Abstenim (Sali Asllanaj), nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksën operacionale prej 0,15% dhe taksën investive prej 0,38%, që është e vlefshme për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012

Shefki Ukaj shkuritimisht prezantoi buxhetin e miratuar dhe shpenzuar të KPM-së sipas kategorive ekonomike. Buxheti i pashpenzuar në vlerë prej 15.550 euro rrjedh si pasoj e emërimit me vonesë të

komisionit dhe bordit të mediave për ankesa. Komisioni i pavarur për media kishte planifikuar që të ketë një ndërtesë të vetën, është ende në shtëpi private me kushte jo të mira për punë. Por në mungesë të lejesë ku është paraqitur një kërkesë e veçantë në kuvendin komunal mjerisht është paraparë që të gjejnë një zgjidhje për të gjitha agjensitë.

Latif Gashi kërkoi sqarime rreth shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit që janë tejkaluar dhe për qfarë janë shpenzuar? Mbi të gjitha më intereson shpejgimi për shpenzimet për derivatet për gjenerator?

Arben Bilalli në mungesë të linjave buxhetore të caktuara sepse në të njëjtin rezervuar e kemi në një pozicio edhe ngrohjen edhe gjeneratorin. Ky shpenzim është i njëjti me vitin 2011 po ndryshimi i qmimit ka ndikuar pak në rritje emtyre. KPM-ja është anëtare e platformës europiane për mediat elektronike dhe jemi anëtar të rregullt por sivjet jemi bërë anëtar edhe të një organizate tjetër që është transeuropiane. Kemi një anëtarësim që e paguajmë edhe jemi obligativ të participojmë për çdo vit 2 konferenca që i mban platforma europiane për media dhe 2 IMRA që është organizata tjetër. Duke pasur parasysh që ka ndodhur strategjia për dixhitalizim ka pasur më shumë udhëtime teknike që janë bërë në regjion kryesisht për mbërritjen e kombinimit pasi që nuk jemi pjesëmarrës të IDU për të kombinuar pikat e strategjisë sonë me vendet në regjion.

Hasime Krasniqi unë mendoj që është një raport i pasqyruar mirë, me të dhëna të detajuara sipas standardit të kontabilitetit ndërkombëtar mirëpo edhe në formë të raportit që ne e kemi kërkuar, por ajo që më bëri përshtypje më tepër përputhja apo shpenzimi 100 % i planifikimit me hargjimin ndoshta edhe me cent kishte sidomos nënkategoritë ekonomike, ky është një fakt që të bënë për të dyshuar?

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2012

Naser Osmani para hapjes së shqyrtimit të kësaj pike, në emër e tij dhe në emër anëtarëve të Komisionit, përshëndeti dhe falenderoi Alexander Beetz, udhëheqësin e Projektit për financat publike të GIZ, për kontributin dhe mbështetjen që ka dhënë për Komisionin tonë për programet që janë financuar nga qeveria gjermane. Vlerësoj se ka qenë korrekt dhe shumë i mirë dhe i urojtë suksese të mëtutjeshme në misionin e tij.

Naser Osmani instituti gjyqësor i Kosovës në bazë të nenit 6.1 të ligjit për institutin gjyqësor të Kosovës i raporton Kuvendit për raportin buxhetor.

Lavdim Krasniqi prezantoi shpenzimet e IGJK-së sipas kategorive ekonomike që në detale ishin pjesë e raportit me shkrim të dorëzuar në Kuvend dhe theksoi se Instituti gjyqësor ka organizuar trajnime të ndryshme për specializimin dhe ngritjen profesionale për anëtarët e institutit. Kjo kërkesë buxhetore është ndarë sipas planifikimit buxhetor. Kategoria që është bërë shpenzimi më i madh është për mallra dhe meditje.

Naser Osmani ajo qka mund të shihet pa hy shumë në analiza e detaje është ajo që ky është një planifikim i mirë. Kjo që është realizuar për mallra dhe shërbime kjo ne vetëm na gëzon sepse kjo është kategoria e vetme që neve na duket mirë kur nuk bëhen shumë shpenzime. Ajo që më intereson ta dijë se

a është shëndrruar në vlerë monetare edhe ndihma materiale që japin donatorët? Nuk kam ndonjë vrejte në lidhje me raportin përpos asaj se pse ka një tejkalim në udhëtime zyrtare dhe për shërbimet telefonike?

Lavdim Krasniqi sipas ligjit për institutin gjyqësor është lënë hapur mundësia që të ketë mbështetje prej donatorëve dhe donatorët japin mbështetje në shërbime të ndryshme dhe nuk derdhen mjete në buxhetin e institutit dhe shuma që është dhënë është shumë që ne e kemi marr sipas raporteve të donatorëve dhe është shëndrruar në shumë monetare.

Latif Gashi në pjesë për mallra dhe shërbimeve, përveq telefonisë janë bërë tejkalim të shpenzimeve edhe në disa nën kategori tjera. Blerja e mobiljeve dhe pajisjeve ku shihet se është një përqindje e lartë e buxhetit që është tejkaluar. Mund të na jepni sqarime se pse është tejkaluar? Ka një tejkalim të shpenzimeve për dreka e pije ku buxheti është shpenzuar rreth 146 %.

Lavdim Krasniqi ne nuk e kemi pasur si trend për blerjen e mobilieve mirëpo në këtë vit ne jemi duke e rregulluar bibliotekën të cilën nuk e kemi pas. Nuk janë shuma shumë të mëdha që janë tejkaluar. Ka qenë e planifikuar por nuk është aprovuar si kërkesë ndërkohë është aprovuar. Për dreka që u përmendën shpenzimet hyjnë tek trajnimet.

Hasime Krasniqi nëse analizojmë raportin shohim se kemi tejkalime në nënkategori të mallrat dhe shërbimet, kam vërejtje që nuk i u keni përmbajtur planifikimeve. Përndryshe është një raport i realizuar mirë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës vitin 2012.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2012

Alban Sutaj paraqet raportin e agjencionit për ndihmë juridike falas që pasqyron kapacitetet për punën një vjeçare për punën e agjencionit. Shkurtimisht prezantoi shpenzimet në total dhe sipas kategorive ekonomike të prezantuara edhe në raportin me shkrim të dorëzuar në Kuvend.

Naser Osmani janë disa tejkalime të buxhetit në disa nën kategori. Nëse ka mundësi të na sqaroni këto.

Daut Morina ne si agjension jemi qdo ditë duke u avancuar në projekte të reja falë UNDP. E kemi tejkaluar buxhetin sepse nuk e kemi paraparë trajnimin e stafit. Ne i kemi kushtuar rëndësi kuadrit të ri që vjen në agjension dhe i kemi trajnuar. E kemi pasur edhe ndërrimin e ID. Ne që nga viti 2006 nuk kemi marrë asnjë pajisje. Gjatë vitit e kemi parë që duhet patjetër të blihen disa pajisje dhe e kemi bërë tejkalimin.

Latif Gashi ju jeni për të bërë planifikim dhe sipas planifikimit të shpenzohen mjetet. I keni tejkaluar buxhetin 9 herë më shumë. Shihet se ka një keq menagjim, keq planifikim. Ju duhet të parashikoni qdo shpenzim, nëse nuk e planifikoni atëherë duhet të pritni për vitin tjetër dhe jo të tejkaloni 9 herë shpenzimet. Pse e keni tejkaluar buxhetin për sigurimin e veturave për 59%?

Drita Rexhepi agjensia për ndihmë juridike falas në kuadër të financimit nga Kuvendi financohen 21 punëtor. Nga programi i UNDP numri është rritur për 50 punëtor më shumë. Ky është i vetmi trajnim që e kemi organizuar ne si agjension.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin vjetor financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas vitin 2012.

6. Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes për kthimin e Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor

Naser Osmani rikujtoje se gjatë shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në Seancë Plenare lidhur me vendimin e Presidentes për kthimin e ligjit, është konstatuar se formulimi i komisionit nuk ka qenë në harmoni me ligjin dhe Kuvendi ka kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Legjislacion të harmonizojnë qendrimet rreth nenit 4. Tani kemi një propozim.

Neni 4 të ndryshohet, si vijon:

Aneksi 1 i këtij ligji mund të ndryshohet dhe plotësohet me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pas propozimit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

- I. Neni 4 i Ligjit për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor të ndryshohet, si vijon:

Neni 4

Ndryshimi dhe plotësimi i Aneksit

Aneksi 1 i këtij ligji mund të ndryshohet dhe plotësohet, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- II. Raport me rekomandim i procedohet Komisionit për Legjislacion për vlerësim sipas kompetencës dhe vendimit të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Naser Osmani edhe me këtë projektligj që jemi komision funksional dhe ende nuk e kemi proceduar për shqyrtim në seancë plenare, është e njëjta qështje që ka të bëjë me nenin 4. Propozoj të ndryshohet ky nen si në vijim:

Neni 4
Ndryshimi dhe plotësimi i Shtojcës

Shtojsa A edhe B e këtij ligji, mund të ndryshohet dhe plotësohet, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pas propozimit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

- I. Neni 4 i Projektligjit për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë

Neni 4
Ndryshimi dhe plotësimi i Shtojcës

Shtojsa A edhe B e këtij ligji, mund të ndryshohet dhe plotësohet, me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- II. Raport me rekomandim i procedohet Komisionit të përhershëm për vlerësim sipas kompetencës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit

Naser OSMANI